



SHKOLLA E MAGJISTRATURËS  
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Programi:

“Përmirësimi i Aftësive Financiare dhe të  
Kontabilitetit për Gjyqtarët dhe Prokurorët”

Moduli 1: Kontabiliteti

CFRR >>

Centre for Financial  
Reporting Reform



WORLD BANK GROUP

Funded by:



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Federal Department of Economic Affairs,  
Education and Research EAER  
State Secretariat for Economic Affairs SECO

CIPFA | UHY Elite  
Auditing, Tax & Consulting



SHKOLLA E MAGJISTRATURËS  
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRIË



Ky program trajnimi është zhvilluar në kuadër të projektit SQARP i cili është i financuar nga SECO dhe zbatohet nga Qendra për Reformimin e Raportimit Financiar (CFRR) e World Bank Group.



Centre for Financial  
Reporting Reform



SQARP is funded by:



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Federal Department of Economic Affairs,  
Education and Research EAER  
**State Secretariat for Economic Affairs SECO**

Trajnimi është zhvilluar në partneritet me “The Chartered Institute of Public Finance and Accountancy” (CIPFA) dhe UHY Elite sh.p.k.

Për më tepër detaje ju lutem na shkruani në adresën: [sqarp\\_albania@uhy-elite.com](mailto:sqarp_albania@uhy-elite.com)



Nëpërmjet këtij materiali, gjykatësit dhe prokurorët do të kenë fituar një kuptim më të qartë të parimeve të kontabilitetit dhe se si ato lidhen me përditshmërinë e tyre.

**SQARP**

Objektivi

Rritje e aftësive të gjykatëseve dhe prokurorëve:

- për të trajtuar aspektet financiare të rasteve gjyqësore,
  - për të komunikuar në mënyrë efektive me ekspertë financiarë, dhe
  - për të marrë vendime të informuara në lidhje me çështjet financiare të rasteve të tyre.
- ✓ Njohja me teknikat e bazë të kontabilitetit, për t'i ndihmuar zbulimin e mashtrimit apo raportimet financiare të pasakta.
  - ✓ Familjarizimi i pjesëmarrësve me evidencën kontabël dhe interpretimin e tyre për qëllime ligjore.
  - ✓ Ndërgjegjësimi për çështjet e ndërthurjes së kontabilitetit me rregullat e fushës ligjore.



# Përmbajtje




- Kontabiliteti dhe dokumentacioni
- Kuadret rregullues
- Raste Praktike

**CFRR** >>  
Centre for Financial  
Reporting Reform



Funded by:

 Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Federal Department of Economic Affairs,  
Education and Research EAER  
State Secretariat for Economic Affairs SECO

Aftësitë e kontabilitetit dhe të raportimit financiar nuk janë vetëm teknike; ato janë thelbësore për drejtësinë. Në këtë seksion, qëllimi është të tregojmë rolin që këto aftësi luajnë në kontekstin ligjor.

## Rëndësia e aftësive të kontabilitetit dhe raportimit financiar për gjyqtarët dhe prokurorët

### Çfarë mundësojnë këto njohuri.

- **Kuptueshmëria e evidencave:** Në proceset ligjore, provat shkojnë përtej dëshmive. Aftësitë e kontabilitetit ndihmojnë në deshifrimin e evidencave financiare, duke siguruar një kuptim tërësor të rasteve.
- **Zbërthimi i kompleksitetit:** Rastet me çështje financiare shpesh janë komplekse. Aftësitë e kontabilitetit orientojnë profesionistët ligjorë nëpërmjet deklarimeve, taksimit dhe kufizimeve të biznesit.
- **Vendimmarrja e informuar:** Gjyqtarët dhe prokurorët marrin vendime thelbësore. Njohuritë e kontabilitetit janë kyçe për zgjedhje të informuara në raste si mosmarrëveshjet, krimet e jakave të bardhë apo ligji i familjes.

### Përfitimet që synohen

Vendimmarrja e paanshme:	<ul style="list-style-type: none"><li>✓ Parimet e kontabilitetit sigurojnë paanshmërinë.</li><li>✓ Gjyqtarët me njohuri financiare do të mund të vlerësojnë evidencat objektivist, pavarësisht zhargonit kompleks.</li></ul>
Efikasitet në Trajtimin e Çështjeve	<ul style="list-style-type: none"><li>✓ Gjyqtarët me njohuri në kontabilitet mund të përshpejtojnë procesin duke kuptuar me shpejt implikimet financiare, e duke adresuar kërkesa koncize ndaj eksperteve.</li></ul>
Drejtësi	<ul style="list-style-type: none"><li>✓ Kuptimi më i plotë i implikimeve financiare si të çështjes ashtu edhe të impaktit që mund të ketë vendimi mbi palët siguron rezultate të drejta.</li></ul>

Kontabilizimi i dyfishtë është themeli i praktikave moderne të kontabilitetit. Ai siguron një mënyrë sistematike dhe të saktë për të regjistruar transaksionet financiare.

## Regjistrimi (kontabilizimi) i dyfishtë – Çfarë është “debi-kredi”-ja

Për të kryer regjistrimet kontabël çdo transaksion përfshin të paktën dy kahe: një debit dhe një kredi.

### Debi

Ka origjinën nga fjala latine "*debere*", që do të thotë "t'i detyrohesh" ose "të marrësh diçka".

### Kredi

Gjithashtu i ka rrënjët në latinisht, nga fjala "*credere*", që do të thotë "t'ia besosh" ose "të japësh diçka".

Për të kryer regjistrimet kontabël nevojitet një dokument ku identifikohen qarte dy kahet (dhe shumat përkatëse).

*Shembull:*

Shitje  
shërbimi te  
klienti me  
pagesë më  
vonë

Debi: Llogaria e Klienti  
*(pra i "besoj" klientit se do më paguaj)*  
Kredi: Llogaria e të ardhurave  
*(pra rrit ose i "jap diçka" të ardhurave)*

Arkëtoj nga  
Klienti paratë

Debi: Llogaria e Arkës  
*(pra i besoj ose shtoj diçka në arkë)*  
Kredi: Llogaria e Klientit  
*(pra ul besimin që i kam dhënë klientit kur faturova shitjen)*

Dokumenti: "**Fature Shitje**"

Dokumenti: "**Mandat Arkëtimi**"

Për të kryer regjistrimet kontabël nevojitet një dokument ku identifikohen qarte dy krahët e transaksionit financiar (dhe shumat përkatëse).

## Dokumentacioni Kontabël

### Dokumentacioni qe përfshin pale jashtë entitetit :

Regjistrohen  
Direkt

- Fatura shitje
- Fatura blerje
- Mandat Arkëtimi
- Mandat Pagese
- Urdhërshirim Bankar
- Mandat Tërheqje nga Banka
- Mandat Deponimi ne Banke
- Mandat Pagese Takse

Regjistrohen  
përmes  
Veprimeve  
Plotësuese

- Kontrata huaje
- Kontrata qiraje
- Kontrata me palët e treta
- Pagesa e taksave
- Listë-pagesa e personelit
- Situacione mujore për punime  
(nëse nuk janë faturuar)
- ....

### Dokumentacioni qe nuk përfshin pale jashtë entitetit :

- Dale nga magazine
- Hyrje ne Magazina
- Lëvizje mes magazinave
- Urdhërshirim I brendshëm
- Mandat Tërheqje nga punonjësi
- Mandat Deponimi nga punonjësi

- Formular për Udhëtime dhe Dieta
- Kontrata me punonjësit
- Procesverbal te diferencave te inventarit/ arkës, aktiveve etj.
- Flete amortizimi
- Flete provigjonimi
- Flete Rivlerësimi
- Flete mbyllje viti kontabël
- Flete për shpërndarjen e fitimit
- ....

Për të kryer regjistrimet kontabël nevojitet gjithashtu dhe llogarite (regjistrat) ku te identifikohen qarte krahët e transaksionit financiar (dhe shumat përkatëse).

## Llogarite Kontabël

Një llogari është një regjistër që ruan dhe organizon transaksionet financiare.

- Çdo llogari përfshihet ne një element të caktuar të pasqyrave financiare të një entiteti, të tilla si aktivet, detyrimet, kapitalin e vet, të ardhurat dhe shpenzimet.
- Llogaritë shërbejnë si gurë themeli për ndërtimin e pasqyrat financiare, të tilla si bilanci, pasqyra e të ardhurave dhe pasqyra e rrjedhës së parasë.
- Për qëllim te ruajtjes sa më të detajuar të transaksioneve financiare, një entiteti nuk limitohet ne çeljen e llogarive megjithatë, limitet mund te vijnë për shkak te sasisë se madhe të të dhënave.

## Klasat e llogarive sipas praktikës ne Shqipëri

- KLASA 1. Llogaritë e kapitalit
- KLASA 2. Llogaritë e aktiveve afatgjatë
- KLASA 3. Llogaritë e inventarit
- KLASA 4. Llogaritë e të drejtave dhe detyrimeve
- KLASA 5. Llogaritë e mjeteve monetare
- KLASA 6. Llogaritë e shpenzimeve
- KLASA 7. Llogaritë e të ardhurave



Klasifikimi i veprimeve kontabël mund të bëhet në disa mënyra duke u bazuar në natyrën e tyre.

## Veprimet kontabël

1. Veprime kontabël të krijuar nga dokumentet bazë kontabël me palë të treta:
  - a. Veprimet e shitjeve
  - b. Veprimet e blerjeve
  - c. Veprimet e pagesave, etj.
2. Veprime të lëvizjeve të brendshme
3. Veprime rregulluese të anulimit, korigjimit, plotësimit.
4. Veprime periodike
5. Veprime për regjistrimin e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara (pa dok. bazë – vlerësime/ hamendësime)
6. Veprimet e rivlerësimit, zhvlerësimit dhe amortizimit.
7. Veprimet e mbylljes së periudhës kontabël

Llogarite dhe regjistrimet përkatëse ne vijim organizohen ne libra te cilat mundësojnë kontrollin e regjistrimeve dhe përgatitjen e raporteve financiare.

## Librat Kontabël

### Librat kontabël përfshijnë

- Ditarët analitike
  - Arkë, Bankë, klientë, furnitorë, magazina, punonjës, etj
- Librat e shitjes
- Librat e blerjes
- Libri i madh i llogarive
  - Kartelat e llogarive, lëvizjet e llogarive
- Bilanci verifikues
  - Tërësia e llogarive kontabël me balancën në një datë të caktuar, ku totali i Balancave debitorë është i barabartë me tepricat kreditore. (debi – kredi = zero)

Ne ditën e sotme, organizimi i sasisë së madhe të të dhënave në regjistrat kontabël domosdoshmërisht kërkon shfrytëzimin e programeve kompjuterikë të dedikuar

### A lejohet përdorimi i programeve të huaja?

Nuk ka ndonjë kufizim ligjor të përcaktuar qartë, por njësitë ekonomike duhet të jetë e gatshme për ti paraqitur informacionet e kërkuara në rrugë ligjore **në gjuhën shqip!**

### A ka kufizime kontabiliteti i mbajtur në Excel?

- Nuk ka garanci profesionale sikurse ka një program i certifikuar.
- Nuk plotëson si duhet kushtin e Partisë dy-fishe të kontabilitetit.
- Nuk jep shumë mundësi përpunimi të dhënash dhe raportime të veçanta.
- Mund të mos kuptohet si duhet nga lexues me njohuri të kufizuara të kontabilitetit.

# Cilët janë rolet e përfshira në kontabilitet dhe Raportim Financiar dhe çfarë përgjegjësish kanë ato?

## Rolet

*Të përfshirë direkt në kontabilitet dhe Raportim Financiar*



### Kontabilist

Regjistron dokumentet bazë të kontabilitetit dhe sigurohet për saktësinë, plotësinë dhe klasifikimin e drejtë të tyre.



### Financier

Kontrollon, vlerëson dhe plotëson sa më lart, dhe bën veprime rregulluese.



### Drejtues i Financës

Aprovon sa më sipër, mbikëqyr anën financiare të shoqërisë dhe raporton tek palët e brendshme dhe të jashtme



### Administrator

Përgjegjës sipas ligjit dhe statutit të shoqërisë



### Audit i Brendshëm

ofron vlerësime të pavarura të proceseve financiare, kontrolleve dhe pajtueshmërisë.



### Audit (i jashtëm)

Jep vlerësim të pavarur të pasqyrave financiare për të verifikuar saktësinë, drejtësinë dhe përputhshmërinë e tyre me standardet dhe rregulloret e kontabilitetit.

*Të përfshirë in-direkt në kontabilitet dhe Raportim Financiar*



### Arkëtari

Përgjegjës për ruajtjen dhe mirë-përdorimin e likuiditetit



### Operacionet | Përdoruesi i një aktivi

Përgjegjës për ruajtjen dhe mirë-përdorimin e aktivitetit që ka në dorëzim

Përgjegjës për shpenzimet përkatëse.



### Drejtori i Shitjeve | Shitjet

Shpesh përgjegjës për regjistrimin e shitjeve.



### Drejtori i Blerjeve | Prokurime

Shpesh përgjegjës për regjistrimin e blerjeve.



### Burimet Njerëzore

Shpesh përgjegjës për regjistrimin dhe deklarimin e pagave dhe shpenzimeve të lidhura me punonjësit.



### Ortakët | Aksionaret

Rishikon dhe analizon pasqyrat financiare për të vlerësuar performancën, për të marrë vendime për investime dhe për të ushtruar të drejtën e votës në mbledhjet e ortakëve/aksionarëve.




- Kontabiliteti dhe dokumentacioni
- **Kuadret rregullues**
- Raste Praktike

**CFRR** >>  
Centre for Financial  
Reporting Reform



Funded by:

 Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Federal Department of Economic Affairs,  
Education and Research EAER  
State Secretariat for Economic Affairs SECO

Kontabiliteti, si gjuha e biznesit, mbështetet në një kuadër të fortë parimesh, ligjesh dhe standardesh për të ruajtur integritetin dhe për të lehtësuar komunikimin financiar.

## Si rregullohet kontabiliteti dhe Raportimi Financiar

### Kuadri rregullues

### Shpjegimi i thjeshtuar

### Shembuj

#### Parime Baze të Kontabilitetit

Janë teknikat themelore që diktojnë se si regjistrohen transaksionet financiare, si raportohen dhe interpretohen për të siguruar saktësi, qëndrueshmëri dhe transparencë në pasqyrat financiare.

- **Parimi i angazhimeve të konstatuara:** transaksionet duhet të regjistrohen në periudhën në të cilën ndodhin, pavarësisht nga kur ndodh këmbimi i vërtetë i parave.
- **Parimi i Përputhjes:** Shpenzimet duhet të njihen në të njëjtën periudhë si të ardhurat përkatëse.

#### Ligjet

- Rregulla që përcaktojnë kuadrin raportues dhe publikimin e informacionit financiar.
- Rregullat fiskale dhe autoritetet rregullatorë të ngarkuara me mbikëqyrjen

- ...
- Ligji “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.
- VKM “Për Mandatimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit”
- Ligji “Për Tatimin mbi të ardhurat”
- Ligji “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”
- ...

#### Standardet

Set udhëzimesh dhe rregullash të vendosura nga ente lokale apo ndërkombëtare që përcaktojnë se si duhet të prezantohen pasqyrat financiare.

- IFRS-Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar
- SKK ose ang: NAS - Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
- GAAP- *Generally Accepted Accounting Principles* - SHBA
- IAASB- Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Auditimit
- SNKSP ose ang: IPSAS - Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
- ...

Ky ligj përcakton parimet dhe rregullat e përgjithshme për hartimin dhe përbërësit e pasqyrave financiare, përcaktimin e standardeve kontabël të zbatueshme, si dhe mbajtjen e kontabilitetit.

Ligji 25.2018 datë 10.05.2018 «PËR KONTABILITETIN»:

### Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet nga njësitë ekonomike që kanë qëllime fitimprurëse, pavarësisht nga forma e tyre juridike dhe njësitë ekonomike jofitimprurëse, me përjashtim të rasteve kur pasqyrat financiare dhe kontabiliteti i tyre janë subjekt i ligjeve ose i rregullimeve të veçanta.

#### Dokumentacioni kontabël

- Natyra,
- Përbërja,
- Koha e mbajtjes (ruajtjes së të dhënave),
- Periudha e raportimit të pasqyrave dhe deklaratave

#### Pasqyrat Financiare

- Përbërja e pasqyrave financiare
- Periudha e raportimit

#### Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit

- Roli,
- detyrat,
- funksionimi

Qëllimi i standardeve kombëtare apo ndërkombëtare është të promovojë transparencën, krahasueshmërinë dhe qëndrueshmërinë në raportimin financiar në shkallë lokale apo globale.

## Kuadret raportuese/ Standardet

Krahasueshmëria globale	Besimi i investitorëve	Lehtësimi i transaksioneve ndërkufitare
<p>Ofrojnë një grup të përbashkët parimesh kontabël që u mundësojnë kompanive të përgatisin pasqyra financiare që mund të krahasohen në vende dhe industri të ndryshme.</p> <p>Kjo promovon transparencën dhe konsistencën në raportimin financiar.</p>	<p>Duke rritur transparencën dhe krahasueshmërinë, ndihmojnë në përmirësimin e besimit të investitorëve në informacionin financiar, duke çuar në vendime investimi të mirë-informuara.</p>	<p>Standardet e qëndrueshme e bëjnë më të lehtë për kompanitë të kryejnë biznes përtej kufijve duke reduktuar kompleksitetin dhe koston e lidhur me rakordimin e pasqyrave financiare të përgatitura duke përdorur parime të ndryshme kontabël.</p>
Pajtueshmëria me rregullat ligjore	Dhënia e informacioneve shpjeguese të zgjeruara	
<p>Shumë vende kërkojnë ose lejojnë përdorimin e kuadreve raportuese të caktuara sipas rregullave ligjore për raportimin financiar.</p> <p>Respektimi i këtyre standardeve i ndihmon kompanitë të përmbushin kërkesat rregullatorë.</p>	<p>Kuadret theksojnë nevojën e shënimeve shpjeguese për përdoruesit e pasqyrave financiare, duke siguruar që palët e interesuara të kenë akses në të gjithë informacionin e nevojshëm për të vlerësuar performancën dhe pozicionin financiar të një kompanie.</p>	

Aktualisht ne Shqipëri kuadri rregullator për Kontabilitetin dhe Raportimin Financiar është kompetencë e KKK dhe shpalljen për përdorim e bënë Ministri i Financave.

### Matrica e kuadrit rregullator të raportimit financiar në Shqipëri

		Institucionet			
		KKK Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	Organizatrat profesionale (IEKA, IKM, etj.)	Bordi i Mbikëqyrjes Publike	MinFin Ministria e Financave
Kuadri rregullator	Ligji për kontabilitetin	✓	✓	✓	✓
	SKK	✓	✓	✓	✓
	SNRF	✓	✓	✓	✓
	Ligji për auditimin	-	✓	✓	✓
	SNA	-	✓	✓	✓
	Kuadri fiskal	-	-	-	✓



Kuadri raportues për njësitë ekonomike janë në varësi të aktivitetit, të madhësisë së xhiros si dhe natyrës së pronësisë.

Kuadret raportuese/ Standardet e zbatueshëm në Shqipëri

	SKK për mikronjësi	SKK	SNRF	OJF	Publike*
Njësi ekonomike me xhiro deri 30 milion lek	✓	-	-	-	-
Njësi ekonomike me xhiro deri 1.25 miliard lek	-	✓	-	-	-
Njësi ekonomike me xhiro mbi 1.25 miliard lek (dhe njësite e specifikuar në publikim)	-	-	✓	-	-
Organizata jo fitim prurëse	-	-	-	✓	-
Njësi ekonomike publike	-	-	-	-	✓

Standardet Kombëtare të Kontabilitetit miratohen nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe shpallen nga Ministri i Financave.

SKK ose ang: NAS\* - Standardet Kombëtare të Kontabilitetit

### 16 Standarde Kombëtare

- Aktualisht janë 16 standarde që rregullojnë kontabilitetin dhe raportimin financiar për entitetet në Republikën e Shqipërisë.
- Përrjashtim nga këto standarde bëjnë njësitë që duhet të raportojnë sipas IFRS dhe organet shtetërore të cilat shpejt do të pritet të kalojnë në IPSAS.

### Lista e SKK në fuqi

- SKK 1 Kuadri i Përgjithshëm
- SKK 2 Paraqitja e Pasqyrave Financiare
- SKK 3 Instrumentet Financiare
- SKK 4 Inventarët
- SKK 5 Aktivitet Afatgjate
- SKK 6 Provizionet, Detyrimet dhe Aktivitet e Kushtëzuara
- SKK 7 Qiratë
- SKK 8 Të Ardhurat
- SKK 9 Kombinimi i Biznesit
- SKK 10 Grantet dhe Ndihmat
- SKK 11 Tatimi mbi Fitimin
- SKK 12 Kurset e Këmbimit
- SKK 13 Aktivitet Biologjike
- SKK 14 Investimet në Pjesëmarrje
- SKK 15 Mikronjësitë
- SKK Për OJF

Standardet e hartuara nga Bordi i Standardeve Kontabël Ndërkombëtare dhe te përkthyer ne shqip, nen përgjegjësinë e Këshillit Kombëtar te Kontabilitetit, shpallen nga Ministri i Financave.

SNK ose ang: IFRS-Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar

### 61 Standarde/Akte deri ne vitin 2023

Zbatohen detyrimisht nga:

- Shoqëritë e listuara ne një burse
- Bankat e nivelit te dyte dhe institucionet financiare te ngjashme me bankat,
- Shoqëritë e sigurimeve dhe te ri-sigurimeve,
- Fondet e letrave me vlere dhe te gjitha shoqëritë e licencuara për te kryer veprimtari investimi ne letrat me vlere.
- Njësi ekonomike te tjera te mëdha, te pa listuara ne burse, kur ato tejkalojnë kufijtë e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave. Aktualisht:
  - Të ardhurat vjetore, në shumën 1'250'000'000 lekë;
  - Numri mesatar i të punësuarve në vit, mbi 100.

### Lista e SNK ne fuqi

- 25 Standarde te kontabilitetit (SNK)
- 16 Standarde te raportimit financiar (SNRF)
- 20 interpretime (KIRNF & KIS)



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I  
KONTABILITETIT

<https://www.kkk.gov.al/>

Gjithashtu subjektet ne sektorë te veçantë i nënshtrohen dhe kuadreve raportues me te specializuar te përcaktuar nga entet mbikëqyrës ku raportohen te dhëna financiare dhe te dhëna te tjera statistikore.

Shembuj te kuadreve raportues te tjerë (financiar ose jo)



### Sistemi Raportues Statistikor

Sistemi raportues statistikor përbën tërësinë e formularëve nëpërmjet të cilëve raportohen të dhëna nga subjektet raportuese për qëllime statistikore

- Për bankat, formularët janë miratuar me vendimin “Mbi raportimet në Bankën e Shqipërisë sipas sistemit raportues të unifikuar” (SRU),
  - ✓ Formularët e raportimit të bankave të nivelit të dytë – SRU
  - ✓ Formularët e mbikëqyrjes së konsoliduar
  - ✓ Formularët e normave të interesit
- Për subjektet financiare jo-banka, formularët e raportimit janë miratuar me vendimin “Për miratimin e sistemit raportues për subjektet financiare jo-banka”.
- Për shoqëritë e kursim kreditit dhe unionet e tyre, formularët e raportimit janë miratuar me vendimin të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës të Shqipërisë .



Modeli Raportues për tregun e sigurimeve, tregun e titujve, tregun e sipërmarrjeve te investimeve kolektive, tregu i fondeve te pensioneve private vullnetare



### Modeli Raportues për çdo Sektor

Ne varësi te burimeve natyrore te shfrytëzuara, agjencia mbledh dhe ruan raportime periodike te subjekteve për qëllime monitorimi dhe statistikore.



**AUTORITETI I MBIKËQYRJES  
SË LOJËRAVE TË FATIT**

.....

Raportimet statutores si një burim alternativ për të verifikuar pretendimet e dorëzuar në gjykatë.

## Raportimet statutores të një njësie ekonomike

### Burimi



### Përmbajtja

Pasqyrat financiare të deklaruara në Tatime (zakonisht deri ne 31 mars):

- Pasqyra e Pozicionit Financiar
- Pasqyra e Performancës
- Pasqyra e Fluksit Monetar
- Pasqyra e Ndryshimeve ne Kapital
- Shënime shpjeguese
- Lista e Automjeteve te Shoqërisë
- Lista e Pasurive te Paluajtshme (ndërtesat)
- Kopja e kontratave te qerese.
- Raporti i Auditimit (nëse duhet)

Te tjera

- Deklarimet e larmishme fiskale.
- Faturat e fiskalizuara në SelfCare
- Inventari i dorëzuar në Tatime
- Akt kontrollet e ndryshme tatimore

Pasqyrat financiare të deklaruara (zakonisht deri ne 31 Korrik) dhe te aksesusheme on-line

- Pasqyra e Pozicionit Financiar
- Pasqyra e Performancës
- Pasqyra e Fluksit Monetar
- Pasqyra e Ndryshimeve ne Kapital
- Shënime shpjeguese
- Raporti i Auditimit nëse duhet
- Vendimi për destinimin e fitimit






- Kontabiliteti dhe dokumentacioni
- Kuadret rregullues
- Raste Praktike

**CFRR** >>  
Centre for Financial  
Reporting Reform



Funded by:

 Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Federal Department of Economic Affairs,  
Education and Research EAER  
State Secretariat for Economic Affairs SECO

Rolet e përfshira ne kontabilitet the raportim financiar ka detyre te analizojnë dhe marrin vendime ne lidhje me pasqyrimin e sakte te transaksioneve.

## Pyetje rreth dokumentacionit kontabël (1/2)

1. Administratori i paraqet kontabilistit një letër me shkrim dore ku shënohet se janë blerë me para në dorë disa tavolina dhe karrige për zyrën e Administratorit në vlerën 153,000 Lek.

Si duhet të veprojë Kontabilisti?

2. Kontabilisti ka marrë një faturë për blerje të 3,000 kg Oriz nga një subjekt i shitjes me shumicë. Kjo faturë nuk është firmosur nga magazinieri, sepse ai ka qenë një javë me leje, dhe gjatë kësaj kohe ai është zëvendësuar nga një punonjës magazine i cili ka lidhje familjare me subjektin që ka shitur Orizin.

Si duhet të veprojë Kontabilisti?

3. Drejtori i Marketingut, shkruan një e-mail për Drejtorin e Financës ku e lajmëron se i ka humbur Laptopin i kompanisë gjatë një udhëtimi në jug të Shqipërisë. A kërkon fonde për të blerë një laptop të ri dhe i kërkon Drejtorit të Financës që ta çregjistrojë laptopin e vjetër.

Si duhet të veprojë Drejtori i Financës?

4. Një Konsulent juridik person fizik ka paraqitur një email te Administratori me kërkesën për të kryer një pagesë prej 360,000 Lek për shërbime avokatie për një rast civil në gjykatë. Konsulenti ka të njëjtin mbiemër me Administratorin. Ky i fundit urdhëron Drejtorin e Financës të kryejë pagesën dhe të regjistrojë shpenzimin në fjalë. Drejtori i financës nuk ka dijeni për ndonjë çështje në gjykatë.

Si duhet të veprojë Drejtori i Financës?

5. Administratori, i ka paraqitur Drejtorit të financës një kontratë dhe faturë për blerjen e një Automjeti luksoz për nevojat e shoqërisë. Drejtori i financës nuk ka informacion se kush do jetë përdoruesi i mjetit dhe ka vërejtur se mjeti është në emër të shoqërisë, por siguracioni është në emër të gruas të njërit nga ortakët në maxhorancë.

Si duhet të veprojë Drejtori i Financës?

Rolet e përfshira ne kontabilitet the raportim financiar ka detyre te analizojnë dhe marrin vendime ne lidhje me pasqyrimin e sakte te transaksioneve.

## Pyetje rreth dokumentacionit kontabël (2/2)

---

6. Administratori i dërgon një e-mail Drejtorit të Financës dhe i kërkon këtij të fundit që të paguajë me urgjencë në llogarinë bankare të Administratorit një shumë prej 3 milion Lek si bonus për arritje të mira. Pasqyrat vjetore nuk janë përgatitur akoma, dhe Administratori nuk ka ndonjë klauzolë në kontratë për bonus arritjesh, por Administratori para disa ditësh ka paraqitur disa dokumente për një udhëtim që do bëjë të nesërmen me Ortakët e shoqërisë jashtë shtetit.

Si duhet të veprojë Drejtori i Financës?

7. Kontabilisti vëren që muajin e kaluar ka reregjistruar një faturë të një furnitori me një shumë të gabuar (një zero më tepër). Sot është dita që do kryet pagesa, dhe drejtori i financës po bën gati Urdhër pagesat. Një rast i tillë me Kontabilistin e mëparshëm ka përfunduar shume keq sepse e kanë pushuar nga puna. Gabimi është rreth 50,000 Lek të reja më tepër aq sa është paga mujore e Kontabilistit. Drejtori i financës bën rakordime çdo tre muaj me Furnitorët.

Si duhet të veprojë Kontabilisti?

8. Arkëtari ka marrë nga gruaja e tij disa monedha të falsifikuara të cilat ja kanë hedhur tek tregu i këmbimit. Ai i zëvendëson ato me monedha të sakta nga arka e shoqërisë dhe pas dy ditësh raporton se ka marrë nga banka disa monedha të çuditshme. Drejtori i Financës kontakton me Bankën dhe Banka raporton se Arkëtari nuk ka tërhequr monedha të asaj prerje nga sporteli i Bankës. Gruaja e Arkëtarit vuan nga një sëmundje e rëndë, kurimi i të cilës është i kushtueshëm. Si duhet të veprojë Drejtori i Financës?

Si duhet të veprojë Drejtori i Financës?





This document has been prepared within the framework of the project “Strengthening Quality of Auditing and Reporting Project for Building Capacity of Judicial System in Financial Reporting” Ref. No: SQARP-AL-CQS-3.1 in the Republic of Albania. This document is prepared by or on behalf of the following entities. It contains confidential and privileged information intended solely for the addressee. In the event that you are not the addressee and have accessed this document in error, please do not read, or disseminate it.



77 Mansell Street, London E1 8AN  
+44 (0)20 7543 5600

[cipfa.org](http://cipfa.org)

The Chartered Institute of Public Finance and Accountancy.  
Registered with the Charity Commissioners of England and Wales No 231060.  
Registered with the Office of the Scottish Charity Regulator No SCO37963.



“UHY ELite sh.p.k (the “Firm”) is a member of Urbach Hacker Young International Limited, a UK company, and forms part of the international UHY network of legally independent accounting and consulting firms. UHY is the brand name for the UHY international network. The services described herein are provided by the Firm and not by UHY or any other member firm of UHY. Neither UHY nor any member of UHY has any liability for services provided by other members.”

Address: Str. "Ibrahim Rugova" Pallati 17, H3, Apt.12, Tirane, Albania  
Tel. +355 4 2237199; +355 4 4502116  
[www.uhy-elite.com](http://www.uhy-elite.com) , [info@uhy-elite.com](mailto:info@uhy-elite.com)